

- на претседателот на комисијата, доколку не донесе решение во рок утврден со членот 177-ј став (10) од овој закон.

Член 230-б

Глоба во износ од 5.000 евра во денарска противвредност ќе им се изрече на членовите на комисијата која го спроведува испитот од членот 177-г став (8) од овој закон, доколку не го прекине испитот согласно со членот 177-е ставови (5) и (6) од овој закон.“

Член 30

Во членот 234 став (2) бројот „168“ се заменува со бројот „163“.

Член 31

Постапките за остварување на правото на посебен додаток, започнати пред денот на започнувањето на примената на членот 2 од овој закон со кој се менува членот 35 од Законот за заштита на децата („Службен весник на Република Македонија” број 23/13), ќе се довршат согласно со одредбите од прописите кои важеле до денот на започнувањето на неговата примена.

Член 32

Единствениот електронски систем за полагање на стручен испит ќе се воспостави во рок од една година од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 33

Започнатите постапки за полагање на стручен испит за директори на установи за деца, стручни работници, стручни соработници, воспитувачи и негователи во установи за згрижување и воспитание на деца од предучилишна возраст; физички лица кои вршат одредени работи од дејноста згрижување и воспитание на деца од предучилишна возраст во сопствениот дом и во домот на родителите на детето; лица вработени во агенциите за давање услуги за чување и нега на деца од предучилишна возраст, како и на лица кои се заинтересирани да се вклучат во системот за згрижување и воспитание на деца од предучилишна возраст до денот на започнувањето на примената на овој закон, ќе завршат според одредбите на прописите по кои започнале.

Член 34

Подзаконските акти предвидени со овој закон се донесуваат во рок од шест месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 35

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Македонија да утврди прецистен текст на Законот за заштита на децата.

Член 36

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“, а одредбите од членовите 2 и 3 од овој закон ќе започнат да се применуваат од 1 јануари 2014 година. Одредбите од членовите 12 и 29 од овој закон ќе започнат да се применуваат во рок од една година од денот на влегувањето во сила на овој закон, а одредбите од членовите 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 и 28 од овој закон ќе започнат да се применуваат од 1 мај 2014 година.

L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJE TË FËMIJËVE

Neni 1

Në Ligjin për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/13), në nenin 12 paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Ndalohet furnizimi ose ofrimi i drogave, substancave psikotropike dhe prekursorëve fëmijës nën moshën 18 vjeçare dhe ndalohen të gjitha aktivitetet joligjore dhe keqpërdorimet e punës së fëmijëve për prodhimin dhe tretinë me droga, substanca psikotropike dhe prekursorë."

Neni 2

Në nenin 35 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Shuma e tatimit të veçantë nga paragrafi (1) i këtij neni, zmadhohet për 50% dhe është 6 303 denarë për prind vetëmbajtës që ka fëmijë me nevoja specifike që ka pengesa në zhvillimin trupor ose mental ose pengesa të kombinuar në zhvillim deri në 26 vite jetë."

Paragrafi (2) i cili bëhet paragraf (3) ndryshohet si vijon:

"(3) Shumat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni harmonizohen me rritjen e shpenzimeve për jetesë për vitin paraprak të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikës, në janar për vitin rrjedhës."

Neni 3

Pas nenit 35 shtohet nen i ri 35-a, si vijon:

"Neni 35-a

Për prind vetëmbajtës të fëmijës për të cilin realizohet e drejta e shtesës së veçantë, në kuptim të këtij ligji, konsiderohet prindi i:

- fëmijës që e mban, nëse prindi tjetër ka vdekur,
- fëmijës që pas vdekjes së njërit prind ka realizuar të drejtën e pensionit familjar, e prindi tjetër është në marrëdhënie pune,
- fëmijës që pas vdekjes së njërit prind ka realizuar të drejtën e pensionit familjar, e prindi tjetër nuk është në marrëdhënie pune,
- fëmijës nga martesë e shkukurëzuar nëse prindi te i cili jeton fëmija nuk jeton në bashkësi martesore, respektivisht jashtëmartesore,
- fëmijës të cilit njëri prind nuk i dihet dhe
- fëmijës të cilit njëri prindi i konsiderohet i zhdukur."

Neni 4

Pas nenit 39 shtohet nen i ri 39-a, si vijon:

"Neni 39-a

Kur rritja e shpenzimeve të jetesës për vitin e kaluar janë më të ulëta nga viti paraprak i harmonizimit ose janë me shenjë negative, nuk bëhet harmonizim me shumat nga nenet 29, 31, 35, 37 dhe 39 të këtij ligji, respektivisht të njëjtat do të sigurohen nga viti i fundit i harmonizimit si më i volitshëm për shfrytëzuesin."

Neni 5

Në nenin 72 fjalët: "neni 69" zëvendësohen me fjalët: "neni 70".

Neni 6

Në nenin 81 paragrafi (2) pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: "të lidhur ndërmjet agjencisë dhe kërkuesit të shërbimeve."

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Pas lidhjes së marrëveshjes nga paragrafi (2) i këtij neni, agjencia për dhënien e shërbimeve për ruajtje dhe përkujdesje të fëmijëve të moshës parashkollore, lidh marrëveshje për punësim me personin që do ta sigurojë shërbimin te kërkuesi."

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

Në paragrafin (4) i cili bëhet paragraf (5) numri "3" zëvendësohet me numrin "4".

Neni 7

Në nenin 84 pas fjalës "moshë" shtohen fjalët: "si veprimtari profesionale".

Neni 8

Në nenin 87 paragrafi (3) pas fjalës "punë" presja dhe fjalët: "e nëse shërbimet i kryen në shtëpinë e vet të marrë" shlyhen.

Neni 9

Në nenin 88 paragrafi (1) numrat: "85 dhe 86" zëvendësohen me numrat: "84, 85 dhe 86".

Neni 10

Në nenin 120 paragrafi (2) fjalët: "neni 135" zëvendësohen me fjalët: "neni 134".

Neni 11

Në nenin 168 pas paragrafit (10) shtohet dy paragrafë të rinj (11) dhe (12), si vijojnë:

"(11) Në kopshtet publike për fëmijë me qëllim të avancimit të zhvillimit të personalitetit të fëmijës, talentit, aftësive fizike, kreative dhe aftësive tjera, detyrimisht realizohen aktivitete programore nga sfera e kulturës, veprimtarisë botuese, përkujdesëse dhe edukuese, ekologjisë, artit, mënyrës së shëndetshme të jetesës, aktivitete rekreative dhe sport, në pajtim me programet nga paragrafi (12) i këtij neni.

(12) Programet nga paragrafi (11) i këtij neni i miraton ministri."

Paragrafët (11) dhe (12) bëhen paragrafë (13) dhe (14).

Neni 12

Pas nenit 177 shtohen 13 nene të reja 177-a, 177-b, 177-v, 177-g, 177-d, 177-gj, 177-e, 177-zh, 177-z, 177-x, 177-i, 177-j dhe 177-k, si vijojnë:

"Neni 177-a

(1) Drejtorët e institucioneve për fëmijë; punëtorët profesionalë, bashkëpunëtorët profesionalë, edukatorët dhe infermierët në institucione për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore, personat fizikë të cilët kryejnë punë të caktuara nga veprimtaria përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore në shtëpinë e vet dhe shtëpinë e prindërve të fëmijës; personat e punësuar në agjencitë për dhënie të shërbimeve për ruajtje dhe përkujdesje të fëmijëve të moshës parashkollore si dhe të personave që janë të interesuar për t'u kyçur në sistemin për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore japin provim profesional për kontroll të njohurisë së nevojshme profesionale për kryerjen e punëve nga veprimtaria.

(2) Provim profesional mund të japë personi që i plotëson këto kushte:

- të ketë diplomë ose certifikatë për arsim të kryer përkatës, në pajtim me nenet 120 paragrafët (2) dhe (3) dhe 134 paragrafët (1), (2), (3), (4), (5), (6) dhe (7) të këtij ligji,

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,

- të ketë certifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore,

- të ketë vërtetim se nuk i është hequr e drejta prindërore,

- të ketë vërtetim se nuk i është shqiptuar dënimi ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

- të ketë vërtetim se nuk i është shqiptuar dënimi me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesje ose abuzim të personit të mitur ose incest, për veprë penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pa marrë parasysh sanksionin e shqiptuar dhe te i cili në përputhje me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese dhe

- të ketë vërtetim me vendim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës derisa zgjasin pasojat e ndalimit.

Neni 177-b

(1) Provimi profesional përbëhet nga dy pjesë si vijon:

- pjesa e parë (pjesa teorike), me të cilën kontrollohet njohuria teorike e kandidatëve dhe

- pjesa e dytë (studim i rastit), me të cilën kontrollohet aftësia praktike e kandidatëve.

(2) Pjesa e parë e provimit nga paragrafi (1) i këtij neni jepet me shkrim në formë elektronike, me përgjigje të numrit të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(3) Pjesa e dytë e provimit përbëhet nga shembulli praktik.

Neni 177-v

(1) Provimi jepet sipas programit në të cilin përmbahen materiali, rregullat dhe literatura.

(2) Programin për dhënien e provimit nga sfera përkatëse e miraton Komisioni për dhënien, përtëritjen, vazhdimin dhe heqjen e licencave për punë të personave që janë të kyçur në sistemin për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore, të drejtorëve të institucioneve për fëmijë si dhe të personave që janë të interesuar që të përfshihen në sistemin për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore.

Neni 177-g

(1) Bazat e pyetjeve për pjesën e parë dhe bazat e shembujve praktikë për pjesën e dytë të provimit nga neni 177-x të këtij ligji, i përpilojnë anëtarët e Komisionit nga neni 175 të këtij ligji.

(2) Pyetjet nga pjesa e parë e provimit dhe pyetjet dhe shembujt praktikë të pjesës së dytë të provimit i verifikon Komisioni për verifikim të pyetjeve, i përbërë nga pesë anëtarë edhe atë dy përfaqësues nga ministria, një profesor nga fakulteti apo instituti për shkencë shoqërore humanitare, të emëruar nga ministri, një përfaqësues nga sindikata reprezentative dhe një përfaqësues i BNJVL-së.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni kryen edhe revizion dhe azhurnim të bazave të pyetjeve dhe bazave të shembujve praktikë nga neni 177-x të këtij ligji së paku një herë në vit.

(4) Gjatë revizionit Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni, në veçanti i ka parasysh ndryshimet e rregullave në të cilat është bazuar pyetja, respektivisht shembulli praktik, numrin e kandidatëve që e kanë përgjigjur, suksesin në përgjigjen e tyre, si dhe kriteret tjera që mund të ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të bazave të nenit 177-x të këtij ligji.

(5) Në bazë të revizionit të kryer dhe azhurnimit të bazave të pyetjeve dhe bazave të shembujve praktikë, Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni, vendos se cilat pyetje dhe shembuj praktikë të ndryshohen ose të mënjanohen tërësisht nga bazat e nenit 177-x të këtij ligji.

(6) Anëtarët e Komisionit nga paragrafi (2) i këtij neni kanë të drejtë në kompensim në para që e përcakton ministri.

(7) Kompensimi vjetor në para nga paragrafi (6) i këtij neni, nuk e tejkalon nivelin e dy rrogave mesatare në Republikën e Maqedonisë për vitin paraprak, të publikuar nga Enti Shtetëror për Statistikë.

(8) Punët profesionale dhe administrative për nevojat e zbatimit të provimit profesional i kryen Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni, kurse provimin teknikisht e zbaton personi juridik i regjistruar në Regjistrin qendror i zgjedhur nga ministri.

Neni 177-d

(1) Provimi profesional zbatohet së paku dy herë në vit.
(2) Kërkesën për dhënien e provimit kandidatët e interesuar, e parashtrojnë te Komisioni nga neni 175 të këtij ligji, së bashku me dëshmi për plotësimin e kushteve për dhënien e provimit, të përcaktuara me këtë ligj.

(3) Komisioni nga neni 175 të këtij ligji, përcakton nëse kandidati i plotëson kushtet për dhënien e provimit.

(4) Për kërkesat e miratuara për dhënien e provimit, Komisioni nga neni 175 i këtij ligji, e cakton kohën dhe vendin e dhënies së provimit, kurse kandidatin e njofton më së voni në afat prej tetë ditëve para dhënies së provimit.

(5) Kandidatit i mundësohet që të fillojë ta japë provimin në terminin e parë të ardhshëm nga dita e kërkesës së miratuar për dhënien e provimit.

(6) Nëse kandidati nuk i plotëson kushtet për dhënien e provimit, Komisioni nga neni 175 i këtij ligji, miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës për dhënien e provimit, kundër të cilit mund të parashtrohet ankesë te ministri.

Neni 177-gj

(1) Provimi profesional jepet në lokal për dhënien e provimit, të pajisur veçanërisht për dhënien e provimit profesional me pajisje materiale-teknike dhe informatike, lidhje interneti dhe pajisje për incizimin e dhënies.

(2) Publiku informohet për datën dhe kohën e dhënies së provimit së paku tri ditë para mbajtjes së provimit.

(3) Dhënia e provimit incizohet dhe drejtpërdrejt emitohet në ueb faqen e ministrisë, e nëse për shkaqe teknike incizimi ndërpritet, incizimi nga i tërë provimi vendoset në ueb faqen e ministrisë.

(4) Kriteret në lidhje me kushtet hapësinore dhe pajisjen materiale-teknike dhe informatike të lokaleve për dhënien e provimit profesional i përcakton ministri.

(5) Në lokalin për dhënien e provimit, gjatë kohës së dhënies së provimit janë të pranishëm së paku tre anëtarë të komisionit dhe informatikani nga ministria.

Neni 177-e

(1) Para fillimit të dhënies së provimit, përfaqësuesi nga komisioni nga neni 175 i këtij ligji, e përcakton identitetin e kandidatit me shikim të letërnjoftimit.

(2) Kandidatit, gjatë kohës së dhënies së pjesës së parë të provimit, nuk i lejohet shfrytëzimi i ligjeve, ligjeve me koment dhe sqarim, telefonit mobil, aparateve kompjuterike portative dhe mjeteve tjera teknike dhe informatike, lëndëve të përgatitura paraprakisht dhe ngjashëm.

(3) Kandidatit, gjatë kohës së dhënies së pjesës së dytë të provimit, i lejohet shfrytëzimi vetëm i ligjeve (pa komente dhe sqarime), që në version elektronik gjenden në kompjuterin në të cilin kandidati e jep provimin.

(4) Kandidatit, gjatë kohës së dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit, nuk i lejohet të kontaktojë me kandidatë ose persona tjerë përveç me informatikanët nga neni 177-gj paragrafi (5) të këtij ligji, në rast se ka problem teknik me kompjuterin.

(5) Nëse problemet teknike me kompjuterin mënjanohehen për pesë minuta provimi vazhdon, e nëse nuk mënjanohehen në këtë afat, provimi ndërpritet vetëm për atë kandidat dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

(6) Nëse ka probleme me më shumë se pesë kompjuterë dhe ato nuk mënjanohehen në afat prej pesë minutash provimi ndërpritet për të gjithë kandidatët që e japin provimin dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri

ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit. (7) Nëse kandidati gjatë dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit, vepron në kundërshtim me paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni, nuk do t'i lejohet dhënia e mëtejme e provimit në atë termin të caktuar.

(8) Në rastet nga paragrafi (7) i këtij neni, konsiderohet se kandidati nuk e ka dhënë provimin dhe kjo konstatohet në procesverbalin për dhënien e provimit.

(9) Përfaqësuesit e autorizuar nga neni 177-gj paragrafi (5) i këtij ligji, gjatë kohës së dhënies së provimit nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë sekonda në afërsi të kandidatit që e jep provimin, përveç në rast të mënjanimin të problemit teknik, kur nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë minuta.

Neni 177-zh

(1) Nëse gjatë dhënies së provimit krijohen shkaqe të arsyeshme për të cilat kandidati nuk mund ta vazhdojë dhënien e provimit (sëmundje, pushim i lindjes dhe ngjashëm), do të ndërpritet provimi për një kohë të caktuar, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se gjashtë muaj.

(2) Aktvendim për vazhdimin e provimit miraton kryetari i komisionit nga neni 175 i këtij ligji, me kërkesë të kandidatit. Kërkesa parashtrohet në afat prej tetë ditëve nga ndërprerja e shkaqeve për prolongimin e provimit, por më së voni në afat prej gjashtë muajve.

(3) Nëse kandidati nuk parashtron kërkesë për vazhdimin e dhënies së provimit në afatin e përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni do të konsiderohet se provimi nuk është dhënë.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të parashtrohet ankesë te ministri në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(5) Në vazhdimin e provimit, kandidati nuk e jep atë pjesë të provimit të cilën paraprakisht tanimë e ka dhënë.

Neni 177-z

(1) Provimi fillon me dhënien e pjesës së parë (pjesës teorike), e pastaj të pjesës së dytë (shembullit praktik).

(2) Pjesa e dytë jepet në afat prej së paku pesë ditësh pas dhënies së suksesshme të pjesës së parë.

(3) Komisioni nga neni 175 i këtij ligji, më afërsisht e përcakton mënyrën e ndarjes së pikëve në pjesën e parë dhe të dytë të provimit.

(4) Kusht për dhënien e pjesës së dytë të provimit është kandidati ta japë pjesën e parë të provimit.

(5) Nëse kandidati nuk e ka dhënë pjesën e parë të provimit në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni, do të konsiderohet se provimin nuk e ka dhënë.

(6) Pjesa e dytë e provimit përbëhet nga shembulli praktik.

(7) Pyetjet të cilat janë pjesë përbërëse e shembullit praktik janë nga sfera përkatëse dhe kanë pesë opsione të mundshme përgjigjesh prej të cilave njëra është e saktë, tri janë të ngjashme dhe dy janë të ndryshme.

(8) Nëse kandidati nuk e ka dhënë pjesën e dytë të provimit, do të konsiderohet se provimin nuk e ka dhënë.

Neni 177-x

(1) Dhënia e pjesës së parë të provimit profesional bëhet me përgjigjen e numrit të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(2) Pyetjet e testit varësisht nga pesha, vlerësohen me pikë të përcaktuara në test.

(3) Dhënia e pjesës së dytë të provimit profesional kryhet me shembull praktik dhe përgjigje të numrit të caktuar të pyetjeve që dalin nga shembulli praktik, në formë të zgjidhjes softuerike elektronike (në tekstin e mëtuftjeshëm: shembull praktik elektronik).

(4) Pyetjet nga shembulli praktik varësisht nga pesha, vlerësohen me pikë të përcaktuara në shembullin praktik.

(5) Pyetjet e përmbytura në testet për dhënien e pjesës së parë të provimit dhe përgjigjet e tyre, si dhe shembulli

praktik dhe pyetjet që dalin nga shembujt praktikë dhe përgjigjet e tyre ruhen në sistemin unik elektronik për dhënien e provimit.

(6) Sistemi elektronik nga paragrafi (5) i këtij neni përmban edhe bazë të kapshme publikisht prej së paku 100 pyetje për çdo sferë, si dhe bazë të kapshme publikisht prej së paku 30 shembujve praktikë për çdo sferë, për nevojat e pjesës së dytë të provimit.

(7) Në sistemin elektronik përmbahet edhe udhëzim për rregullat dhe literaturën në të cilat përmbahen përgjigjet e pyetjeve nga pjesa e parë e provimit dhe rregullat për pjesën e dytë të provimit.

(8) Rezultatet nga dhënia e pjesës së parë dhe të dytë të provimit, kandidati i ka të kapshme në kompjuterin në të cilin e ka dhënë provimin, menjëherë pas përfundimit të tij.

Neni 177-i

(1) Në ditën e dhënies së pjesës së parë, përkatësisht pjesës së dytë të provimit, përfaqësuesi i Komisionit nga neni 175 i këtij ligji, kandidati i jep kod të qasjes, përkatësisht fjalëkalim me të cilin i lejohet qasje në sistemin elektronik nga neni 177-x të këtij ligji.

(2) Pas lejit të qasjes, kandidati merr test elektronik për pjesën e parë të provimit, përkatësisht shembull praktik elektronik për pjesën e dytë të provimit, të gjeneruara në mënyrë kompjuterike, përmbajtjen e të cilave sipas zgjedhjes së rastësishme e cakton softueri i sistemit elektronik nga neni 177-x paragrafi (5) i këtij ligji, nga bazat nga neni 177-x paragrafi (6) i këtij ligji.

(3) Pjesa e parë dhe e dytë e provimit, përmbajnë udhëzim për mënyrën e zgjidhjes së të njëjtit, për të cilin jep sqarim përfaqësuesi i Komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni, para fillimit të dhënies së provimit.

(4) Sistemi elektronik për dhënien e provimit nuk mund të lejojë ekzistimin e përmbajtjes identike të testit elektronik për pjesën e parë të provimit, përkatësisht shembullin praktik elektronik për pjesën e dytë të provimit në një termin për më shumë se një kandidat.

(5) Në rast të pengimit të realizimit të pjesës së parë ose të dytë të provimit për shkaqe që shpijnë në pamundësi teknike të funksionimit të sistemit elektronik nga neni 177-x të këtij ligji, dhënia e provimit ndërpritet.

(6) Nëse shkaqet nga paragrafi (5) i këtij neni mënjahohen në afat prej 60 minutash nga ndërprerja e provimit, ai vazhdohet menjëherë pas mënjanimit të tyre.

(7) Nëse shkaqet nga paragrafi (5) i këtij neni nuk mënjahohen në afatin nga paragrafi (6) i këtij neni, provimi ricaktohet për termin tjetër.

(8) Kohëzgjatja e përgjithshme e kohës së caktuar për përgjigje të pyetjeve nga pjesa e parë e testit për dhënien e provimit, është 120 minuta.

(9) Konsiderohet se provimin e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve të testit ka arritur së paku 70% nga numri i përgjithshëm i pikëve të parapara pozitive.

(10) Kohëzgjatja e përgjithshme e kohës së caktuar për përgjigje të pyetjeve nga secili prej shembullit praktik të pjesës së dytë, është 120 minuta.

(11) Konsiderohet se provimin e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve nga shembulli praktik, ka arritur së paku 70% nga numri i përgjithshëm i pikëve të parapara pozitive.

Neni 177-j

(1) Kandidatëve që e kanë dhënë provimin profesional u lëshohet certifikatë për punë në afat prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të provimit, që paraqet vërtetim se kandidati me sukses e ka kaluar kontrollin e zbatimit të njohurisë profesionale për marrje të licencave nga neni 178 paragrafët (2) pikat 1, 2, 3 dhe 4, (3) dhe (4) të këtij ligji.

(2) Formën dhe përmbajtjen e certifikatës nga paragrafi (1) të këtij neni i përcakton ministri.

(3) Me kërkesë të kandidatit, Komisioni nga neni 175 i këtij ligji, e informon për gabimet e bëra në testim për dhënien e provimit profesional me mundësim të shikimit të drejtpërdrejtë të testit.

(4) Testet dhe shembujt praktik shfrytëzohen dhe i jepen kandidatit vetëm gjatë kohës së dhënies së provimit profesional.

(5) Materialet nga provimet e mbajtura, veçanërisht versionet në letër nga testet dhe shembujt praktikë për dhënien e provimit profesional dhe specimenet për kontroll të saktësisë së përgjigjeve të testit dhe shembullit praktik, ruhen në ministri nga person përgjegjës, anëtar i komisionit.

(6) Ministri formon Komision për revizion të provimeve të mbajtura, që në punën e vet i shfrytëzon materialet nga paragrafi (5) i këtij neni.

(7) Komisioni nga paragrafi (6) i këtij neni mban mbledhje së paku njëherë në vit dhe kryen revizion të mënyrës së realizimit të së paku dy provimeve të mbajtura në vitin rrjedhës.

(8) Komisioni nga paragrafi (6) i këtij neni ka të drejtë të kryejë revizion edhe të mënyrës së realizimit të provimeve të mbajtura në dy vitet e fundit deri në ditën e mbajtjes së mbledhjes së komisionit, por jo më herët nga dita e zbatimit të këtij ligji.

(9) Nëse Komisioni nga paragrafi (6) i këtij neni, konstaton parregullsi në realizimin e provimit nga individë sipas nenit 177-e paragrafi (5) i këtij ligji, propozon heqjen e certifikatës nga paragrafi (1) i këtij neni.

(10) Komisioni miraton aktvendim për heqjen e certifikatës në bazë të propozimit të Komisionit nga paragrafi (6) i këtij neni në afat prej tri ditëve nga pranimi i propozimit.

(11) Kundër aktvendimit nga paragrafi (10) i këtij neni mund të parashtrahet ankesë te ministri në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

Neni 177-k

Komisioni e vendos sistemin unik elektronik për dhënien e provimit profesional."

Neni 13

Në nenin 206 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Mbikëqyrjen inspektuese e kryejnë inspektorë, kurse inspektor mund të jetë personi, i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- është i moshës madhore,
- ka aftësi të përgjithshme shëndetësore,
- nuk i është shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka marrë së paku 300 kredi sipas SETK ose shkallë të mbaruar VII/1 nga sfera e shkencave shoqërore, që dëshmohet me certifikatë,
- ka pesë vite përvojë pune në veprimtari,
- i plotëson kushtet tjera të përcaktuara në aktin për sistematizimin e vendeve të punës,
- posedon certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht për punë me programe kompjuterike për punë në zyre, si vijon:
 - 1) Certiport: IC3 GS4 Key Applications - të dhënë;
 - 2) Microsoft: MOS Word ose MOS Excell – të dhënë ose

3) ECDL: Core - të dhënë,

- ka marrë mendim pozitiv për përshtatshmëri për vendin e punës përmes dhënies së testit psikologjik, testit të integritetit, në pajtim me rregullat që kanë të bëjnë me nëpunësit shtetërorë dhe

- ka licencë për inspektor në sferën e kompetencave të shërbimit inspektues."

Në paragrafin (2) fjalët: "dhe autorizon nëpunës tjetër shtetëror" shlyhen.

Neni 14

Në nenin 207 paragrafi (1) pas fjalëve: "të këtij ligji" shtohen fjalët: "pa marrë licencë nga neni 206 paragrafi (1) alineja 10 të këtij ligji."

Në paragrafin (3) fjalët: "dhe nëpunësi i autorizuar shtetëror i ministrisë" shlyhen.

Në paragrafin (4) fjalët: "dhe nëpunësi i autorizuar shtetëror i ministrisë" shlyhen.

Neni 15

Në nenin 208 fjalët: "dhe nëpunësi i autorizuar shtetëror" shlyhen.

Neni 16

Pas nenit 208 shtohet nen i ri 208-a, si vijon:

"Neni 208-a

(1) Ministri përpilon propozim-program vjetor për punë të shërbimit inspektues dhe atë e dorëzon te Këshilli inspektues më së voni deri më 31 tetor në vitin rrjedhës për vitin e ardhshëm.

(2) Ministri e miraton programin vjetor për punë nga paragrafi (1) i këtij neni në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të pëlqimit, përkatësisht më së voni deri më 10 dhjetor të vitit rrjedhës nëse Këshilli inspektues nuk e shqyrton dhe nuk dorëzon pëlqim.

(3) Në bazë të programit të miratur vjetor, ministri përpilon plane tremujore për punën e çdo inspektori, të cilat në mënyrë përmbledhëse i dorëzon për shqyrtim te Këshilli Inspektues më së voni dy javë para fillimit të tremujorit të ardhshëm kalendarik edhe atë deri më 15 dhjetor për tremujorin e parë nga viti i ardhshëm, deri më 15 mars për tremujorin e dytë, deri më 15 qershor për tremujorin e tretë, respektivisht deri më 15 shtator për tremujorin e katërt të vitit rrjedhës.

(4) Në planet tremujore për punë për çdo inspektor, ministri detyrimisht e fut numrin e mbikëqyrjeve të planifikuara për tre muajt e ardhshëm, si dhe shkallën e ndërlikueshmërisë së secilës prej mbikëqyrjeve.

(5) Në bazë të planeve tremujore, për çdo inspektor, ministri përpilon plan mujor për punë, plan i cili përmban edhe orar të mbikëqyrjeve sipas datave dhe sipas subjekteve të mbikëqyrjes.

(6) Ministri më së voni dy javë nga fillimi i tremujorit kalendarik rrjedhës për atë paraprak, te Këshilli inspektues dorëzon në mënyrë përmbledhëse raporte tremujore për punën e çdo inspektori, edhe atë deri më 15 janar për tremujorin e katërt të vitit paraprak, deri më 15 prill për tremujorin e parë, deri më 15 korrik për tremujorin e dytë, respektivisht deri më 15 tetor për tremujorin e tretë të vitit rrjedhës.

(7) Ministri, më së voni deri më 1 mars të vitit rrjedhës, te Këshilli inspektues dorëzon raport vjetor për punën e shërbimit inspektues për vitin paraprak.

(8) Kryetari i komunës dhe i komunës së Qytetit të Shkupit e miraton programin vjetor për punë të shërbimit inspektues më së voni deri më 15 dhjetor të vitit rrjedhës, për vitin e ardhshëm."

Neni 17

Në nenin 209 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Mbikëqyrja e rregullt inspektuese është mbikëqyrje e paralajmëruar."

Në paragrafin (4) fjalët: "dhe nëpunësi i autorizuar shtetëror" shlyhen.

Neni 18

Në nenin 211 fjalët: "dhe nëpunësi i autorizuar shtetëror" shlyhen.

Neni 19

Në nenin 212 në paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (5) fjalët: "dhe nëpunësi i autorizuar shtetëror" shlyhen.

Neni 20

Në nenin 213 fjalët: "dhe nëpunësi i autorizuar shtetëror" shlyhen.

Neni 21

Në nenin 214 paragrafët (1), (7) dhe (8) fjalët: "dhe nëpunësi i autorizuar shtetëror" shlyhen.

Në paragrafin (11) fjalët: "dhe nëpunësit e autorizuar shtetërorë" shlyhen.

Neni 22

Në nenin 215 paragrafët (1) dhe (3) fjalët: "dhe nëpunësi i autorizuar shtetëror" shlyhen.

Neni 23

Në nenin 216 paragrafët (1) dhe (2) fjalët: "dhe nëpunësi i autorizuar shtetëror" shlyhen.

Neni 24

Në nenin 217 paragrafi (1) fjalët: "dhe nëpunësi i autorizuar shtetëror" shlyhen, ndërsa fjalët: "komisioni i përbërë prej tre anëtarëve dhe zëvendësve të tyre të emëruar nga ministri, kryetari i komunës, komunës në Qytetin e Shkupit dhe i Qytetit të Shkupit" zëvendësohen me fjalët: Komisioni Shtetëror për Vendimarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë."

Paragrafi (2) shlyhet.

Paragrafët (3), (4) dhe (5) bëhen paragrafë (2), (3) dhe (4).

Neni 25

Në nenin 218 paragrafët (1) dhe (2) fjalët: "dhe nëpunësi i autorizuar shtetëror" shlyhen.

Neni 26

Në nenin 220 paragrafi (1) fjalët: "dhe nëpunësi i autorizuar shtetëror për zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese" shlyhen.

Neni 27

Në nenin 228 paragrafi (1) alineja 3 fjalët: "paragrafi (12)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (14)".

Në alinenë 4 fjalët: "paragrafi (11)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (13)".

Pas alinesë 4 shtohet alineja e re 5, si vijon:

"- nuk i realizon programet e detyrueshme të miratuara nga ministri (neni 168 paragrafi (11))."

Neni 28

Pas nenit 229 shtohet nen i ri 229-a, si vijon:

"Neni 229-a

(1) Gjobë në shumë prej 500 deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit i cili është i kyçur në sistemin për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore, drejtorit të institucionit për fëmijë, si dhe personit fizik i cili është i kyçur në sistemin për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore të angazhuar nga agjencia për dhënie të shërbimeve për ruajtje dhe përkujdesje të fëmijëve të moshës parashkollore dhe nga personi fizik i cili punë të caktuara nga veprimtaria kryen si veprimtari profesionale, nëse nuk posedon licencë përkatëse për punë (neni 178 paragrafi (1)).

(2) Gjobë prej 500 deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës në institucionin për fëmijë, përkatësisht personit fizik i cili në mënyrë të mëvetësishme kryen punë të caktuara nga veprimtaria përkujdesje dhe edukim të fëmijëve, si veprimtari profesionale në shtëpinë e vet, përkatësisht personit përgjegjës të agjencisë për dhënie të shërbimeve për ruajtje dhe përkujdesje të fëmijëve të moshës parashkollore nëse punëson person i cili nuk posedon licencë të vlefshme përkatëse për punë (neni 178 paragrafi (1))."

Нени 29

Пас нени 230 сhtohen dy nene të reja 230-a dhe 230-b, si vijojnë:

"Нени 230-a

Gjobë në shumë prej 2 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'u shqiptohet për kundërvajtje:

- përfaqësuesve të autorizuar nga neni 177-gj paragrafi (5) të këtij ligji, nëse gjatë kohës së dhënies së provimit qëndrojnë më gjatë se pesë sekonda në afërsi të drejtpërdrejtë të kandidatit që e jep provimin (neni 177-e paragrafi (9)) dhe

- kryetarit të komisionit nëse nuk miraton aktvendim në afat të përcaktuar me nenin 177-j paragrafi (10)) të këtij ligji.

Нени 230-b

Gjobë në shumë prej 5 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'u shqiptohet anëtarëve të komisionit që e zbaton provimin nga neni 177-g paragrafi (8) i këtij ligji, nëse nuk e ndërpret provimin në pajtim me nenin 177-e paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji."

Нени 30

Нë nenin 234 paragrafi (2) numri "168" zëvendësohet me numrin "163".

Нени 31

Procedurat për realizimin të drejtës së shtesës së veçantë, të filluara para ditës së fillimit të zbatimit të neni 2 të këtij ligji, me të cilin ndryshohet neni 35 i Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/13), do të përfundohen në përputhje me dispozitat e rregullave në fuqi deri në ditën e zbatimit të tij.

Нени 32

Sistemi unik elektronik për dhënien e provimit profesional do të vendoset në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Нени 33

Procedura e filluara për dhënie të provimit profesional për drejtorë të institucioneve për fëmijë, punëtorë profesionalë, bashkëpunëtorë profesionalë, edukatorë dhe infermierë në institucione për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollorë; persona fizikë të cilët kryejnë punë të caktuara nga veprimtaria përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollorë në shtëpinë e vet dhe në shtëpinë e prindërve të fëmijës; persona të punësuar në agjencitë për dhënie të shërbimeve për ruajtje dhe përkujdesje të fëmijëve të moshës parashkollorë si dhe të personave që janë të interesuar për t'u kyçur në sistemin për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollorë deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, do të përfundojnë sipas dispozitave të rregullave sipas të cilave kanë filluar.

Нени 34

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Нени 35

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve.

Нени 36

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", kurse

dispozitat e neneve 2 dhe 3 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2014. Dispozitat e neneve 12 dhe 29 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, kurse dispozitat e neneve 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 maji 2014.

312.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ВЕШТАЧЕЊЕ

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за вештачење, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 17 јануари 2014 година.

Бр. 07- 325/1
17 јануари 2014 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
Горге Иванов, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.

З А К О Н

ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ВЕШТАЧЕЊЕ

Член 1

Во Законот за вештачење ("Службен весник на Република Македонија" број 115/10), во членот 4 став (2) зборовите: „или роковите определени од страна на нарачателот“ се бришат.

Член 2

По членот 5 се додава нов член 5-а, кој гласи:

„Член 5-а

(1) За потребите на органите на државната управа, јавните прептријатија и акционерските друштва во државна сопственост, вештачење врши Бирото за судски вештања по претходно поднесено писмено барање за вештачење во соодветните области.

(2) Формата и содржината на образецот на писменото барање ги пропишува министерот за правда.“

Член 3

Членот 9 се менува и гласи:

“(1) Стручниот испит се полага заради проверка на потребното стручно знаење од соодветната област.

(2) Стручен испит може да полага лице кое ги исполнува следниве услови:

- да е државјанин на Република Македонија,
- да има живеалиште во Република Македонија,
- да има високо образование од соодветната област (диплома за завршено четиригодишно високо образование или диплома со 300 кредити според европскиот кредит трансфер систем (ЕКТС)),

- со правосилна одлука да не му е изречна забрана за вршење на професија, дејност или должност се додека траат последиците од забраната и